

# 20

## Situata të të shkruarit, të cilat janë veçanërisht të përshtatshme për mësimin në gjuhën e prejdardhjes

### Qëllimi

Shumë nga idetë e shfletuara deri më tash mundësojnë që pa problem të merren në mësimin e gjuhës së prejdardhjes. Situatat vijuese të të shkruarit japin nxitje të tjera për këtë. Ato qëndrojnë në lidhje të ngushtë tematike qoftë me vendin e prejdardhjes ose për jetën në dhe mes dy kulturave dhe gjuhëve, ashtu si edhe është karakteristike për nxënësit/et e mësimin në gjuhën e prejdardhjes.

### 1. Tekste me gjëegjëza

kl. 4-9

30 min.



N marrin për detyrë për të përshkruar diçka nga historia, kultura ose gjeografia e vendit të prejdardhjes, pa e përmendur emrin e ngjarjes përkatëse, gjegjësisht personalitetit përkatës ose të qytetit. Tema do të duhej të kufizohet në kuadër të historisë, kulturës, gjeografisë ose të personaliteteve. Ushtrimi mund të bëhet së pari me gojë, në vazhdim duhet që gjëegjëzat të formulohen me shkrim, të mblidhen dhe të shkëmbehen.

### 2. Reportazhet, pllakatet, referatet

kl. 3-9



Tek ky projekt i madh mësimor N krijojnë një reportazh, një pllakat ose një referat për një vend, një ngjarje ose personalitet nga vendi i prejdardhjes. Forma e krijimit do të diskutohet me N (p.sh. pllakat ose referat me fletën përkatëse të punës). Kërkesat natyrisht do të caktohen sipas moshës. Për projektin (përfshirë prezentimin) duhet të llogariten dy ose më shumë orë dyshe. Është e arsyeshme që të bëhet e ditur para pushimeve të gjata, ashtu që N gjatë pushimeve të mund të mbledhin material dhe të përgatiten.

### 3. Fletët e punës, tekste tematike, kuiz etj.

kl. 4-9

45 min.



Në vend që M për mësimin në gjuhën e prejdardhjes të bëjë gati fletët e punës, tekstet tematike, fotografitë, prezentimet përmes kompjuterit etj. këtë mund ta bëjnë nganjëherë edhe nxënësit/et shumë mirë. Me këtë rast ata edhe mësojnë gogja dhe e përsëritin përmbajtjen. Me rëndësi është që paraprakisht të merren vesh, se çfarë duhet të krijohet (p.sh. një fletë pune ose një kuiz me rastin e përfundimit të një teme).

### 4. Intervistat, intervistat fiktive

kl. 5-9



N marrin për detyrë për të zhvilluar intervista për një temë të caktuar bashkërisht që më parë, këtë t'a dokumentojnë me shkrim dhe t'ia prezentojnë klasës. Tema të mundshme dhe partnerët/et intervistues/e: Kujtimet e prindërve ose gjyshërve tanë për fëmijërinë e tyre në vendin e prejdardhjes / Intervistë me dikë që është moshatar në vendin e prejdardhjes për temën koha e lirë dhe perspektivat për të ardhmen / Intervistë me njerëzit në vendin në të cilin N jetojnë, për temat si racizmi, të huajt, integrimi. Me rëndësi: paraprakisht duhet të diskutohet me N se si bëhet një intervistë: të shënohen pyetjet kryesore, pyetjet e hapura të formulohen (jo pyetje po/jo, por më shumë impulse: «Tregoni ju lutem pak, ...», intervistuesi/ ja vetë të flas pak. Edhe forma e dokumentimit me shkrim duhet të sqarohet: Jo të shkruhet gjithçka fjalë për fjalë, por të përmblihet. Një mjet për inçizim: magnetofon ose telefoni i dorës.

Variant nxitës: të sajohen dhe të shënohen intervista fiktive me personalitete të mëdha nga kultura ose politika kombëtare.

### 5. Kërkesa, thirrje

kl. 5-9

45 min.



Në vazhdim të diskutimeve të gjendjeve të pakënaqshme ose të ngjarjeve në vendin e prejdardhjes ose në vendin e tanishëm, do të mendohet se kujt do të mund t'i drejtohen me një kërkesë për përmirësimin e gjendjes ose si do të duhej një thirrje për gazetatat. Në vazhdim N i shkruajnë tekstet përkatëse dhe i diskutojnë bashkërisht. Se a do të dërgohen kërkesat vërtet apo do të shërbejnë vetëm si tekste fiktive, duhet të vendoset nga rasti